



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 15 dhe nenit 33 të Ligjit për planifikimin hapësinor nr. 2003/30, të nenit 11 të Ligjit për ndryshimin e Ligjit për planifikimin hapësinor 2003/14, nr. 03/L - 106 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 42/2008), të nenit 17 dhe nenit 58 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 03/L - 040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), të nenit 16, pika 16.1, shkronja **b**, nenit 32, pika 32.1, shkronja **e** dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 455, të dt. 31.3.2008, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 23.7.2009, merr

V E N D I M
PËR FILLIMIN E HARTIMIT TË PLANIT RREGULLUES
"KOLOVICA E RE" NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues "Kolovica e Re" në Prishtinë.

Neni 2

Qëllimi i nxjerrjes së Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, është rregullimi i hapësirës dhe urbanizimi, sipas destinimeve të planifikuara me Planin strategjik -zhvillimi urban i Prishtinës, i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr. 01-031-1231/1, të dt. 2.7.2004, brenda kufijve të përshkruar në nenin 3 të këtij Vendimi.

Neni 3

Me Planin rregullues, nga neni 1 i këtij Vendimi, do të përpunohet pjesa e territorit të qytetit të Prishtinës, e emërtuar "Kolovica e Re", e cila nga ana përëndimore përkufizohet me rr. "Haxhi Zeka", vazhdon në drejtim të anës verilindore duke u përkufizuar me trasenë e Unazës së brendshme dhe vazhdon në drejtim të juglindjes, që kufizohet me Planin rregullues "Sefalia", vazhdon përgjatë rrugës " Ali Pashë Gucia" deri te udhëkryqi i rrugës "Viktor Hygo", duke vazhduar rrugës "Ernest Koliqi" dhe përmbillet te udhëkryqi i rrugës "Haxhi Zeka," në sipërfaqe prej 130 ha.

Kufijtë e përshkruar të hapësirës nga par. 1 i këtij neni, janë të paraqitur në pjesën grafike, e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Bartësi i detyrave programore dhe i hartimit të Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, do të përcaktohet përmes procedurës së tenderimit. Drejtoritë tjera të Komunës së Prishtinës janë të obliguara që të sigurojnë dhe t'i dërgojnë shënimet e kërkuara nga Drejtoria e Urbanizimit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit, të cilat konsiderohen të jenë të nevojshme për hartimin e Planit rregullues sipas këtij Vendimi.

Neni 5

Mjetet financiare për hartimin e Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, do të sigurohen nga buxheti i Komunës së Prishtinës.

Neni 6

Plani Rregullues, sipas këtij Vendimi, do të miratohet me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, si projektplan, në mënyrë që ai t'i nënshtrohet diskutimit publik para finalizimit dhe miratimit përfundimtar të tij.

Derisa të bëhet miratimi përfundimtar i Planit rregullues për hapësirën e përshkruar në nenin 3 të këtij Vendimi, kërkesat e qytetarëve për zhvillim të punimeve do të zgjidhen përmes dhënies së pëlqimit në lokacion, me mundësinë e inkorporimit të lokacionit përkatës në Planin rregullues të këtij kompleksi.

Neni 7

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit të Komunës së Prishtinës.

Neni 8

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr.35-1443, më23.07.2009

KRYETARI I KOMUNËS

Prof.dr. Isa Mustafa

A r s y e t i m

Në bazë të Planit të punës për vitin 2009, lidhur me detyrat programore për fillimin e hartimit të planeve hapësinore, urbane dhe rregulluese, duke pas si bazë Planin strategjik - zhvillimi urban i Prishtinës, të miratuar me Vendim të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-031-1231/1, dt. 02.07.2004, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit, i jep përparësi hartimit të Planit rregullues "Kolovica e Re".

Kufijtë e përshkruar të hapësirës janë të paraqitura edhe në pjesën grafike, e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Qëllimi i hartimit të këtij Plani rregullues është rregullimi i hapësirës, urbanizimi dhe mbrojtja e vlerave të trashëgimisë historike, kulturore dhe ambientore, sipas destinimeve të planifikuara me Planin strategjik - zhvillimi urban i Prishtinës, nr. 01-031-1231/1, dt. 2.7.2004, brenda kufijve të përshkruar më lart.

Hartimi i këtij Plani do t'i besohet ofertuesit të zgjedhur në përputhje me dispozitat e Ligjit të prokurimit publik.